

UDHËZIME PËR PËRCAKTIMIN EIDENTITETIT TË MIGRANTËVE TË PARREGULLT

(HARMONIZIMI I PROCEDURAVE TË IDENTIFIKIMIT)
PËR PJESËMARRËSIT NË MARRI

JANAR 2016

1 | HYRJE

Qëllimi i këtij dokumenti është të japë një pasqyrë të hapave që duhen ndërmarrë me qëllim të harmonizimit të procedurave të përcaktimit të identitetit të një personi (të emigrantit) të përfshirë në procedurat e autoriteteve kompetente të vendeve pjesëmarrëseve tek MARRI.

Identiteti është një grup i karakteristikave juridike (emri, mbiemri etj) dhe fizike (pamja) e një individi që dallojnë atë/atë nga një tjetër.

Ky dokument merr parasysh legjislacionin kombëtar të pjesëmarrësve MARRI dhe nuk paragjykon ndonjë dispozitë të legjislacionit kombëtar ose praktikat administrative të pjesëmarrësve MARRI. Përcaktimi dhe konfirmimi i identitetit bazohet në legjislacionin kombëtar të pjesëmarrësve MARRI. Të gjithë pjesëmarrësit në MARRI përcaktojnë identitetin e një të huaji në bazë të dokumenteve të vlefshme (letër njoftimi, pasaportë). Kjo mund të jetë vendosur si një standard minimal të të gjithë pjesëmarrësve në MARRI për verifikimin absolut të identitetit.

2 | QËLLIMI

Qëllimi i procesit të identifikimit është për të siguruar që personat e përfshirë në procedurat me autoritetet kompetente janë identifikuar si duhet.

3 | SFIDAT

- A) Kryerja e kërkimit të duhur të një migranti dhe sendet e tija/saja për dokumentet përkatëse sipas legjislacionit kombëtar.
- B) Krijimi i besimit fillestar ndërmjet emigrantëve dhe oficerëve përmes intervistës.
- C) Vëmendje e veçantë duhet të fokusohet në përzgjedhjen e duhur të përkthyesve.
- D) Të merret një deklaratë fillestare nga një emigrant, ku ai/ajo deklaron identitetin e tij/saj (me njohjen për pasojat në rast mashtrimi)
- E) Emigrantët nuk kanë dokumente që paraqesin identitetin e tyre (dokumentet janë humbur gjatë udhëtimit, dokumentet ju janë marrë nga lehtësuesit ose emigrantët nuk kanë interes për të siguruar dokumentet për arsye të ndryshme, etj).

- F)** Pranim i dokumentacionit tjetër përveç atyre që tregojnë identitetin e një migranti. Dokumentet mbështetëse janë zakonisht ato që nuk kanë foto apo vulë/nënshkrim nga autoriteti që e ka lëshuar. Dokumentet mbështetëse janë gjithnjë e më shpesh të përdorura në procesin e përcaktimit të identitetit. E njëjta gjë vlen edhe për fotokopje të dokumenteve.
- G)** Vlerësimi i vërtetësisë të dokumentacionit duhet të jetë pjesë e procedurës së rregullt përndryshe ajo mund të çojë në rritjen e përpjekjeve për t'ju shmangur autoriteteve me dokumente të falsifikuara.
- H)** Nivele të ndryshme të identitetit të përcaktuar: në procesin e kthimit identiteti i migrantit të parregullt duhet të përcaktohet/konfirmohet pasi që në procesin e mbrojtjes ndërkombëtare identiteti nuk është një faktor vendimtar.
- I)** Verifikimi dhe përcaktimi i vendit të origjinës dhe përcaktimi i identitetit të një migranti duhet të kryhet në përputhje me ligjin.
- J)** Faktor i rëndësishëm është edhe identifikimi i grupeve në nevojë (duke përfshirë vlerësimin e moshës), lehtësuesve, të dyshuar për aktivitete kriminale dhe ballafaqim me grupe më të mëdha.
- K)** Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve të trajnuar mirë që punojnë me emigrantë për rëndësinë e kontrollit/verifikimit të dokumentit.

4 | METODAT

Pavarësisht nga metodat e përdorura për përcaktimin e identitetit, parimet themelore të barazisë, diversitetit dhe mosdiskriminimit duhet të ndiqen gjatë tërë procedurës së përcaktimit të identitetit. Fokus i veçantë duhet pas për individët të cilët janë në rrezik të lëndimit fizik dhe psikologjik, viktimat e trafikimit dhe për ata që nuk mund të kujdesen për veten e tyre dhe (grupet vulnerabël) të tjerë.

Përdoren metoda të ndryshme për përcaktimin e identitetit tek pjesëmarrësit e MARRI-t në rastet e të huajit me dokumente, apo të huajit pa dokumente.

QËLLIMI KRYESOR:
të konfirmohet identiteti i personit

A) TË HUAJIT ME DOKUMENTE

Kryesisht pjesëmarrësit në MARRI përcaktojnë identitetin duke përdorur dokumentet e paraqitura (thelbësore, dokumente mbështetëse ose kopje të këtyre dokumenteve) të siguruara nga një migrant dhe me ekzaminimi/verifikim të dokumenteve. Në këtë rast, autoritetet kompetente duhet të kenë mundësinë për të dërguar dokumentin tek njësitë kompetente të specializuara të pjesëmarrësit në MARRI, përgjegjës për vlerësimin e autenticitetit të dokumenteve.

B) I HUAJI PA DOKUMENTE

Metodat e përdorura për të përcaktuar identitetin në mungesë të informacionit të besueshëm

Në raste kur migranti nuk ka dokumente pjesëmarrësit në MARRI mund të përdorin një nga metodat e mëposhtme se si të përcaktojnë identitetin e një migranti:

- ▶ Intervistë me migrantin
- ▶ Krahasimi i gjurmëve të gishtërinjve me bazat e të dhënave kombëtare dhe bazat tjera
- ▶ Krahasimi i fotografive me bazat e të dhënave kombëtare dhe ato tjera
- ▶ Konsultime me vendin e origjinës (nëpërmjet kanaleve diplomatike apo oficerët ndërlidhës)

Pjesëmarrësit në MARRI poashtu duhet të konsiderojnë futjen dhe përdorimin (ku nuk ka të tilla) e metodave të tjera, të tilla si:

- ▶ Analiza e ADN-së
- ▶ Vlerësimi i moshës
- ▶ Metoda shtrënguese, duke përfshirë kërkimet e detyruara të pronës së migrantit
- ▶ Analizë të gjuhës së folur.

INTERVISTË ME MIGRANTIN

QËLLIMI KRYESOR: për të mbledhur mjaft informata relevante, për të verifikuar dhe për të konfirmuar deklaratat nëse ato janë në përputhje me dokumentet mbështetëse dhe identitetit të deklaruar.

Intervista duhet të kryhet në një mënyrë për të identifikuar vendin e origjinës së të huajit me besueshmëri të lartë. Kjo duhet të pasohet nga themelimi i identitetit personal të të huajit. Intervista duhet t'i mundësojë një të huaji që të vërtetojë identitetin e tij/e saj) a) i huaji duhet të deklarojë shprehimisht identitetin e tij/saj dhe b) i huaji duhet të sigurojë dëshmi për të dëshmuar identitetin e tij/saj. Provat do të konfirmohen si të vlefshme dhe/ose të vërteta dhe se i përkasin individit.

Çështja e gjuhës si nevojë që të kuptohet një i huaj duhet të adresohet në mënyrë të duhur. Për këtë arsye pjesëmarrësit në MARRI duhet të angazhojnë përkthyes si mjet të rëndësishëm për përcaktimin e identitetit. Përkthyesi ka një rol të rëndësishëm gjatë kryerjes së intervistës me një të huaj, por ai/ajo nuk duhet të ketë rol udhëheqës - intervista duhet të udhëhiqet nga zyrtari përgjegjës. Zgjedhja e mirë e përkthyesit dhe bashkëpunimi i mirë duhet të rezultojë në cilësi më të mirë të intervistës.

PËRDORIMI I PYETËSORIT

Pjesëmarrësit në MARRI mund të përdorin pyetësor (të thjeshtë) për ekzaminim fillestar dhe për të identifikuar/konfirmuar identitetin kombëtar/etnicitetin. Më tej, pyetësi mund të zgjatet me pyetje të detajuara në lidhje me identitetin personal, grupet, lehtësuesit, shumat, keqpërdorimin e dokumenteve, duke identifikuar grupet në nevojë, etj. arsyet për largimin nga vendi i origjinës.

Në pyetësor duhet përfshirë një grup të pyetjeve si minimum për konfirmimin e identitetit kombëtar:

1. Informacione bazë për vendin (flamuri, himni kombëtar, presidenti, institucionet, etj).
2. Feja, grupet etnike, gjuhët, dialektet.
3. Pyetje të hollësishme për ndarjen administrative (qarku, kantone, krahina, kryeqyteti, etj).
4. Pyetje në lindhje me fotografi.
5. Pyetje lidhur me udhëtimin.

Teknika dhe mjete të tjera të rekomanduara dhe të zhvilluara nga organizatat përkatëse ndërkombëtare së bashku me institucionet kombëtare.

5 | PROCEDURAT/ HAPAT:

Nga i huaji do të kërkohet të deklarojë të dhënat personale (emrin, datën e lindjes dhe adresën, etj) **Identit i pretenduar**.

Nga i huaji do të kërkohet të **ofrojë dëshmi** për identitetin e deklaruar (secili pjesëmarrës në MARRI duhet krijuar një listë të dëshmive të kërkuara).

Dëshmitë e dhëna duhet të kontrollohen për të përcaktuar nëse janë të vërtetë dhe/ose të vlefshme (**Validitet**).

I huaji duhet të krahasohet me dëshmitë e ofruara dhe/ose njohurinë në lidhje me identitetin e deklaruar për të përcaktuar nëse kjo lidhet me atë/ate (**Verifikim**).

Identiteti i deklaruar duhet t'i nënshtrohet kontrolleve për të përcaktuar nëse ka pasur një ekzistencë (të dhënat).

Në fund të procesit identiteti i deklaruar është ose i konfirmuar (pjesërisht i konfirmuar) ose nuk është i konfirmuar. Nëse është e aplikueshme, identiteti pjesërisht i konfirmuar pjesërisht duhet të përshkruajë nivelin e besimit.

	DOKUMENTI	NDJEKJA
VLERËSIMI I DOKUMENTIT	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Shqyrtoni të gjitha dokumentet në tërësi kundër falsifikimit (ku ekspertiza e tillë është në dispozicion) ▶ Verifikoni dokumentet e paraqitura a janë të vërteta (me bazat e të dhënave dhe të sistemeve kombëtare, INTERPOL, EUROPOL, ambasadat) ▶ Kontrolloni për pulla hyrje/dalje, vizat etj, për të konfirmuar rrëfimin e aplikantit ▶ Verifikoni se si është marrë dokumenti (sidomos në rastet kur këto dokumente në përgjithësi nuk kanë qenë të paraqitura) ▶ Kërkoni te aplikanti dhe në pronën e tij/saj për dokumente përkatëse sipas legjisllacionit kombëtar 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Nëse dokumentet janë gjetur të jenë të falsifikuara, aplikantit duhet t'i jepet mundësia për të shpjeguar se si ai/ ajo ka marrë ato. ▶ Cila është rëndësia e dokumentit të paraqitur.

	DEKLARATA	PËRCJELLJA
MBLEDHJA E INFORMACIONEVE PËR IDENTIFIKIM	<ul style="list-style-type: none"> ▶ I jepni mundësi të të huajit që ta deklarojë qartë identitetin e tij/saj ▶ Kërkoni prej të huajit të jape prova për identitetin e tij/saj ▶ Përdoreni formularin e standardizuar/pyetëSORIN për të mbledhur informata bazike personale për identifikim (emër, mbiemër, etj.) ▶ Fokusimi në çështjet në lidhje me përcaktimin/verifikimin e identitetit ▶ Angazhimi i përkthyesit <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përdorni pyetëSORIN për ekzaminim fillestar dhe për identifikim/konfirmim të identitetit kombëtar/etnik. PyetëSORI mund të zgjerohet me pyetje të detajuara në lidhje me grupet, lehtësuesit, rrugët, shumat e paguara, keqpërdorim të dokumenteve, identifikim grupet në nevojë, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Vlerësoni/krahasoni informatat e mbledhura me dokumentet e prezantuara/dokumentet shtesë ▶ Vlerësoni besueshmërinë/kontraditat me deklaratën e individave ose grupeve

	INTERVISTA	PËRCJELLJA
KONFIRMIM I “RRËFIMIT”	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Përgatitja për intervistë duke përdorur teknika moderne, shkëmbim të informatave ▶ Intervista duhet të merret individualisht e jo si një procedurë rutinë ▶ Mblidhni informacione të sakta dhe të besueshme në lidhje me arsyet e aplikantit për të aplikuar për mbrojtje në mënyrë të drejtë dhe efikase ▶ Ndhmoni aplikantin për të dhënë një llogari të plotë të historisë së tij/saj duke bërë pyetje të duhura në mënyrën e duhur ▶ Jepni mundësi aplikuesit që të qartësojë çdo mospërputhje të mundshme ▶ Mblidhni informacion mbi arsyet për largimin nga vendi i origjinës ▶ Vëzhgoni pamjen e jashtme të aplikuesit (karakteristikat e fytyrës, ngjyra e lëkurës ...) dhe përfundoni duke u bazuar në përvojën personale 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Vlerësoni nëse rrëfimi përputhet me dokumentet e prezantuara/ IVO ▶ Duhet të keni bashkëpunim të mire me përkthyesin
	BIOMETRIKA	PËRCJELLJA
MERRNI GJURMËT E HISHTAVE DHE FOTOGRAFI	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Merrni gjurmët e gishtërinjve sipas legjislacionit përkatës ▶ Verifikoni gjurmat ndaj bazat e të dhënave në dispozicion ▶ Fotografoni aplikuesin ▶ Kontrolloni të dhënat personale kundër bazave të të dhënave kombëtare (alarme, kërkime, vizat, kalimin e kufijve...) dhe ndërkombëtare (si p.sh. Interpol) 	

	BASHKËPUNIM ME AMBASADAT/KONSULLATAT	PËRCJELLJA
BASHKËPUNIM	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Mbani bashkëpunim të mirë me ambasadat (departamentet konsullore e, policisë dhe atasheve kulturorë) dhe konsullatat ▶ Verifikoni dokumentet dhe/ose informatata perms ambasadave ▶ Angazhimi I zyrtarëve ndërlidhës (përshpejtim i procesit, shkëmbim i informatave) 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Vazhdoni të mbani bashkëpunim të mire me aktorët ndërkombëtarë të pranishëm në vend.

	INFORMATA PËR VENDIN E ORIGJINËS - IVO	PËRCJELLJA
HISTORIATI	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kërkoni dhe njoftohuni me IVO më të reja që të kuptoni situatën e aplikuesit ▶ Përdorim korrekt i IVO-së së fituar ▶ Linqe me IVO në dispozitë (shtojcë e këtij dokumenti) 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Konfirmoni ose theksoni mospërputhje me elemente të deklaratës së tij/saj dhe IVO.

	SHKËMBIMI I INFORMATAVE	PËRCJELLJA
	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Shkëmbim i informative me autoritetet përkatëse në vend si dhe me shtetet tjerame qëllim të përcaktimit të identifikimit (p.sh.: PCC SEE) 	

BASHKËPUNIM ME OJQ-të dhe ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE**PËRCJELLJA****BASHKËPUNIM**

- ▶ Kërkoni nga organizatat relevante ndërkombëtare ndihmë për përcaktim të identitetit (p.sh. UNCHR, IOM)
- ▶ Kërkoni nga OJQ-të përkatëse ndihmë për përcaktim të identitetit kur është e nevojshme
- ▶ Shkëmbeni informata përkatëse me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të për rastin me qëllim që të merrni informata për përcaktimin e identitetit
- ▶ Bashkëpunim me të huajt nga vendet e treta (që jetojnë në vend dhe me njohuri përkatëse të vendit të origjinës)

VENDI I ORIGJINËS LINQE TË DOBISHME:

EUROPEAN ASYLUM SUPPORT OFFICE	https://easo.europa.eu/asylum-documentation/easo-publication-and-documentation/	Dokumente Publike në dispozicion që përshkruajnë situatat e përgjithshme në vendet e zgjedhura.
EUROPEAN COUNTRY OF ORIGIN INFORMATION	www.ecoi.net	Vendi i Origjinës – system informativ i Kryqit të Kuq Austriak, përmbledh, strukturon and proceson informata publike për vendin e origjinës me fokus në nevojat e avokatëve për azil, këshilltarët për refugjatë dhe personat që vendosin mbi kërkesat për azil dhe forma të tjera të mbrojtjes ndërkombëtare.

REFWORLD	www.unhcr.org/refworld/	Ofron për situatat e përgjithshme në vendet e zgjedhura.
AMNESTY INTERNATIONAL	www.amnesty.org	Ofron për situatat e përgjithshme në vendet e zgjedhura.
HUMAN RIGHTS WATCH	www.hrw.org	Provides for general situations in the area of human rights in selected countries.
INTERNATIONAL CRISIS GROUP	I.OIpç	Ofron për situatat e përgjithshme në fushën e të drejtave të njeriut në vendet e zgjedhura.
UK BORDER AGENCY	www.gov.uk/government/collections/country-information-and-guidance	Ofron raportime dhe jep informata për Vendin e origjinës të azilkërkuësve.
UK FOREIGN & COMMONWEALTH OFFICE	http://centralcontent.fco.gov.uk/	Ofron për situatat e përgjithshme në vendet e zgjedhura.
KURDWATCH	www.kurdwatch.org/	Ofron raportime për shkeljen e drejtave të njeriut kundër Kurdëve në Siri.



British Embassy
Skopje

Ambasada Britanike në Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit Përmirësimi i procedurave për themelimin e identiteti i parregullt emigrantëve në rajonin MARRI. Përbajtja e këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

